Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Enver Bytyçi	**05.01.2024**	**15.01.2024**	**2024/0009**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.01.2024, OE "NPN EUROING SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0009, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "HARST Group" SH.P.K., Harstgroup, 23000 Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i fushave te tenisit – Qendra Sportive ne Prizren" me nr. të prokurimit: "207-23-10441-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 625,000.00 €.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2024/0009 i dt:04.01.2024. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

LIGJI Nr. 04/L-042 - Neni 10

Neni 56 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 62 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Njoftimi për kontratë në këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt.29/09/2023 ndërsa hapja e ofertave është bërë me datë 10/11/2023 ku kanë ofertuar gjashtë (6) ofertues.

Me datë 22/12/2023 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë OE **Harst Group SH.P.K.,Harstgroup,23000 Suharekë,Kosovë** ndërsa ne jemi eliminuar padrejtsisht me arsyetimin se na **mungojnë:**

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimi për kontratë ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme në vlerë minimum 550,000.00 Euro (projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të objekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna)

Deshmit e kerkuara dokumentare;
Dëshmia 1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve

Sa i përket arsyjës së eleminimit së pari ju sqarojmë se ne kemi prezantuar projektet tona të cilat janë të argumentuara me referenca dhe pranime teknike në një vlerë prej **8,877,264.17Euro** ku prej tyre **855,383.87** janë **OBJEKTE SPORTIVE pra siç është kërkuar me dosjen e tenderit** (***projekte të realizuara në lëminë e ndërtimit të objekteve sportive***, *stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna*) **të dëshmuara me referenca dhe pranime teknike në dokumentacionin tonë ofertues të cilat i gjeni të bashkangjitura përsëri me këtë ankesë.**

Me datë **25/12/2023** kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim tek AK ku me datë **27/12/2023** kemi pranuar përgjigjen ku kërkesa jonë për rishqyrtim është cilësuar si e pabazuar **me arsyetimin se nuk kemi paraqitur (kontrata të natyrës së ngjashme) objekte sportive** dhe ka shënuar se ***"AK ka vërejtur se objektet e paraqitur nga ana juaj nuk kanë tribuna"***.

Përgjigje për pretendimin 1.
Duke u bazuar në kriterin 1. Të pika 9.1 dhe 9.2. Kapaciteti teknik dhe profesional: ku theksohet: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimi për kontratë ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme në vlerë minimum 550,000.00 Euro (projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të **objekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna**), ju si Operator Ekonomik nuk keni paraqitur asnjë objekt sportiv, stadiume apo salla sportive **te cilat përfshinë tribuna** (ashtu siç është kërkuar në Formularin e Dosjes se Tenderit) dhe si e tillë Kërkesa për rishqyrtim hidhet poshtë si e pabazuar, pasi qe AK ka vërejtur se objektet e paraqitura nga ana e juaj nuk kanë tribuna.

Ndërsa projekti i tenderuar nga AK me titull "Ndërtimi i Fushave të tenisit-Qendra Sportive Prizren" **NUK KA TRIBUNA**, ju lutemi shikoni Projektin EGZEKUTUES si dhe paramasën dhe parallogarinë (i gjeni të bashkangjitura), ku shihet qartë se askund nuk ka tribuna. Fatkeqsisht ku shihet qartë tendenca e AK për eleminim të padrejtë të kompanisë tonë.

Kjo procedurë e prokurimit e shpallur nga MKRS që do të ndërtohet është një Objekt Sportiv pra tregon titulli i kontratës "Ndërtimi i fushave të tenisit – Qendra Sportive në Prizren" dhe si kriter në DT për ofertim ka kërkuar kontrata të natyrës së ngjashme pra (objekte sportive,stadiume,palestra,salla).

Çuditërisht në këtë rast Palestrat-Sallat e Edukatës Fizike në vlerë (855,383.87Euro) të dëshmuara me referenca dhe pranime teknike nga ana jonë gjatë fazës së ofertimit sipas AK nuk qenkan objekte sportive,projekte të natyrës së ngjashme.

Pra AK ka kërkuar referenca të punëve të kryera të natyrës së ngjashme në lëminë e ndërtimit objekte sportive **apo** stadiumeve **apo** sallave sportive që përfshijnë tribuna në vlerë prej minimum 550,000.00Euro.

AK-MKRS në Dosjen e Tenderit ka kërkuar *(projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të objekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna)* .
Pra ka dhënë mundësi zgjedhjeve të kontratave me natyrë të ngjashme, OSE të jenë **OBJEKTE SPORTIVE, OSE STADIUME OSE SALLA** QË PËRFSHIJNË TRIBUNA.

Pra projektet tona të argumentuara me referenca janë palestra-salla sportive dhe janë OBJEKTE SPORTIVE ashtu siç është kërkuar nga AK të cilat përdoren eksluzivisht vetëm për aktivitete sportive të cilat kapin vlerën 855,383.87Euro dhe plotsësojnë/tejkalojnë kërkesën e AK në DT minimum 550,000.00Euro (Shih fig1.).

EUROING
NDËRMARRJA PËR PROJEKT M DHE NDËRTIM

LISTA E PROJEKTEVE TË REALIZUARA (OBJEKTE SPORTIVE)

Nr.	Emri i Projektit dhe Nr.Prokurimit	Vendi i ndërtimit	Investitori,Personi Kontaktimes (tel,e-mail)	Adresa e Investitorit	Data e Kontraktimit	Data e Perfundimit	Referenca	Vlera e kontratës
14	Ndërtimi I salles se edukatës fizike te shkollës fëmëro Ermiq-Deçan, Nr I prokurimit: 100-19-025-521	Ermiq-Deçan	"Mashë" Jeberën Tafilaj email: Jeberën.Tafilaj@rks-gov.net tel: 038/212-879	Prishtinë	12/09/2019	12/09/2022	Referenca-Pranim Teknik	€ 300,248.23
16	Ndërtimi I salles se edukatës fizike te shkollës fëmëro SEMU Hasbi Hoti-Rugovë, Gjakovë Nr.Prokurimit:100019026521	Gjakovë	"Mashë" Jeberën Tafilaj email: Jeberën.Tafilaj@rks-gov.net tel: 038/212-879	Prishtinë	23/06/2019	30/04/2021	Referenca	€ 297,194.84
17	Ndërtimi I salles se edukatës fizike ne sh.L Ibrahim Maçovës ne Malishevë Nr.Prokurimit:2017-19.191.515	Malishevë	"Mashë" Jeberën Tafilaj email: Jeberën.Tafilaj@rks-gov.net tel: 038/212-879	Prishtinë	21/03/2019	30/04/2021	Referenca	€ 297,940.88
		TOTALI I KONTRATAVE:						855,383.87 €

Fig.1

Duke vazhduar tutje pra që përpos kësaj ne kemi edhe rreth 1 milion euro kontrata aktive (ongoing) të cilat janë të natyrës së ngjashme pra objekte sportive. **(Shih fig.2)**

EUROING

NËNKOMPANIA PËR PROJEKTIM DHE INDERTIM

LISTA E PROJEKTEVE TË REALIZUARA (OBJEKTE SPORTIVE) ON GOING

Nr.	Emri i Projektit dhe Nr.Pozicionit	Vendi i zbatimit	Investitori,Personi Kontaktues (tel,e-mail)	Adresa e Investitorit	Data e Kontraktimit	Data e Perfundimit	Deklarimi	Vlera e kontratës
5	Ndërtimi i objektit te salles se Edukatës Fizike dhe sportdrejtuese se SHFMU « Abdyl Frashëri » , prizren	Prizren	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Njësinë Ikonike email: nlamnaj.Ikonike@rks-gov.net tel: 038/212-079	Prizren	25.08.2023	Vazhdon	/	€ 344,036.01
10	Ndërtimi i salës si sportsive në SHFMU " Abdullah Koçanaj " në fshatin Korrën – Komunës	Korrëni/Komunës	"Modi" Njësinë Ikonike email: nlamnaj.Ikonike@rks-gov.net tel: 038/212-079	Prishtinë	10/03/2022	Vazhdon	/	€ 299,076.16
11	Ndërtimi I kompleksit sportiv ne zonen turistike te Rahovecit	Rahovec	KK-Rahovec -Astrit Mullabazi, email:prokurimi.rahovec@gmail.com tel: 044/553 038	Rahovec	25/10/2021	Vazhdon	/	€ 356,151.85
		TOTALI I KONTRATAVE:						999,262.30 €

Fig. 2

Në mungesë të bazës së eliminimit, AK-ja ka dhënë përgjigje jo të drejtë të eliminimit edhe pas kërkesës tonë për rishqyrtim, prandaj nga dëshmitë e prezantuara nga ne shihet qartë që projektet tona të natyrës së ngjashme objekte sportive janë adekuate dhe në harmoni me kërkesën e dosjes së tenderit.

Nëse eventualisht autoriteti kontraktues ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me ndonjë kontratë apo referencë atëherë është dashur të kërkojë sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së edhe pse dëshmitë e prezantuara nga ne janë shumë të qarta dhe në harmoni me kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Pretendimi ankimor 2)

Sipas LIGJI Nr. 04/L-042 - Neni 10 me datë **22.12.2023** pas njoftimit mbi vendimin e AK kërkuam qasje në dokumente zyrtare ku nuk kemi pranuar përgjigje nga ana e AK.

Ditë e Mërkure **(27.12.2023)** ne telefonuam dhe biseduam me z.Egzon Zariqi përmes numrit zyrtar kontaktues "038/20022520" ku pastaj pranuam aprovimin për qasje në dokumenta me datë **28.12.2023**.

Gjithsesi ne si kompani ishim prezent tek zyra e Prokurimit ku ishte prezent z.Driloni dhe pranuam dokumentat e kompanive ofertuese **duke përjashtuar** OE të rekomanduar për kontratë "Harst Group" SHPK **me arsyetimin se të gjitha dokumentat janë të cilësuara si sekret afarist** përveq Paramasës, Certifikatës së Biznesit dhe Sigurimit të Tenderit dhe Deklaratës nën Betim.

Pra qartazi është shkelur LIGJI Nr. 04/L-042 - Neni 10 pasi **nuk mund të cilësohet sekret afarist CV, Diplomat e Inxhinierëve, Librezat e Makinerive,ISO standartet etj..** ashtu siç e parasheh **neni 11 paragrafi. 3.1 Ligjit Nr. 04/L-042.** Kjo qështje është rregulluar edhe nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik si dhe nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (ku kemi disa vendime ku rregullohet qasja në dokumentacione zyrtare dhe çka mund të cilësohet sekret afarist).

Gjithsesi ne përsëri kemi kërkuar qasje në dokumente zyrtare përmes email (gjeni të bashkangjitur email-in) të OE të rekomanduar për kontratë po me atë datë **28/12/2023 por përsëri jemi refuzuar.**

Andaj supozojmë që oferta e OE "Harst Group" ka mangësi !

Pretendimi ankimor 3)

Pas analizave të ofertave financiare të OE ofertues në këtë procedurë të prokurimit kemi vërejtur që **pozicioni i konstruksionit metalik përbën rreth 50% të totalit të gjithë vlerës investive të projektit.**

Më poshtë gjeni të bashkangjitur tabelën ku shihet qartë manipulimi i çmimeve të OE të rekomandur për kontratë si dhe tendenca e AK duke e shpallur fitues po të njejtën kompani.

ÇMIMI I HEKURIT(KONSTRUKSIONIT METALIK) NGA OFERTUESIT NË PROJEKTIN Ndërtimi i fushave të tenisit – Qendra Sportive në Prizren "207-23-10441-5-1-1"					
Nr.	*KOMPANITË OFERTUESE*	*Sasia*	*çmimi për kg*		*Gjithsej*
1	GOE Pro-& Co Group SH.P.K.; ARCHI TIME SH.P.K.; FlorinG SH.P.K.; Euro Commerc	140703.46 kg	€	1.50	€ 211,055.19
2	NPN EUROING SHPK	140703.46 kg	€	1.60	€ 225,125.54
3	HARST GROUP SHPK , Harstgroup, (OE REKOMANDUAR)	140703.46 kg	€	0.50	€ 70,351.73
4	GOE NIKA Pro-Ing SH.P.K.;ENGINEERING RK SH.P.K	140703.46 kg	€	1.80	€ 253,266.23
5	EBK SH.P.K	140703.46 kg	€	1.50	€ 211,055.19
6	GOE N.N.P ATC COM SH.P.K.; DAJTING SH.P.K.	140703.46 kg	€	1.65	€ 232,160.71

Mesatarja e Çmimit të Kontruksionit Metalik e Të Gjithë Ofertuesve	€ 226,532.57
HARST GROUP SHPK	€ 70,351.73
Rreth 70% më lirë se mesatarja e çmimit të gjithë ofertuesve për konstruksion metalik	

Përshkrimi i pozicionit në paramasë:

**Furnizimi me material (profile metalike) prerja, saldimi ,përgaditja dhe montimi i konstruksioneve metalike te perbera nga Profilet: IPBl400 per shtylla dhe trare. Profilat duhet te lyhen me baze parangjyre dhe ngjyre me nuance sipas organit mbikqyres ose menaxherit te projektit. Qmimi per kg.*

Nga tabela shihet qartë se të gjithë ofertuesit tjerë në përjashtim të OE të rekomanduar si fitues nga AK , janë me çmime konkuruese reale të tregut ndërsa kompania "Harst Group" e rekomanduar **ka çmim manipulues,joreal me çmimin e tregut dhe të ofertuesve të tjerë pra rreth 70% më lirë në total në raport me mesataren e OE ofertuesve tjerë sa i përket konstruksionit metalik(pozicion domimant rreth 50% e komplet projektit)** ku dhe në formë tabelare kemi paraqitur manipulimet e çmimeve nga ky OE.

AK sipas nenit 61 paragrafi 2 nga LPP është dashur që të kërkoj përgjigje dhe shpjegime mbi këtë anomali të çmimeve tek OE i rekomanduar ashtu siç kërkon paragrafi 2.1. "*ekonominë e procesit të prodhimtarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit*" si dhe 2.2. "*çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur.*"

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve dhe duke mos u shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "**Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".**

Duke pasur parasysh të gjitha sqarimet që u cekën më lartë, kuptohet qartë se ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, prandaj është dashur të shpallemi të përgjegjshëm dhe të rekomandohemi për kontratë.
Duke u bazuar në te gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së dhe nenit 40 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se, **sepse ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.**
Çmimi që ne kemi ofertuar është **547,645.23€,** kurse OE i rekomanduar për kontratë është në vlerë prej **562,562.00€,** e që rezulton se diferenca e ofertimit është në vlerë prej: **14,916.77€,** e që është diferencë e konsiderueshme dhe që mund të përdoren këto mjete për ndonjë projekt tjetër.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, ndërsa ju në këtë rast keni vepruar në kundërshtim me këto dispozita dhe duke e rrezikuar dëmtimin e buxhetit pa ndonjë arsye konkrete, **duke na eliminuar neve si ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.**

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga AK që të nxjerr:

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e **N.P.N. EUROING SH.P.K**
ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së(B58) dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM, ndërsa rivlerësimi i** ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

KRITERET PËR VLERËSIM

	ërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
	Kërkesa numër 1	**Deklarata nën Dëshmitë për kërkesën nr.1**

		betim se operatori ekonomik i përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë sipas LPP nr. 04 L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 – forma Aneksi 2, dosja e tenderit.	**Deklaratë nën betim - e plotësuar, e nënshkruar dhe e vulosur.**
		Kërkesa numër 2 Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit -vetëm për fituesin.	**Dëshmitë për kërkesën nr.2. Një vërtetim nga Administrata Tatimore - vetëm për fituesin.**
		Kërkesa numër 3 Vërtetimin nga Gjykata- Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë"- te jete i lëshuar se paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit, origjinal kopje e noterizuar - vetëm për fituesin.	**Dëshmitë për kërkesën nr.3 Vërtetimin nga Gjykata - origjinal ose kopje e noterizuar- vetëm për fituesin.**
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	**ërshtatshmëria profesionale:**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
		Kërkesa numër 1. Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik.	**Dëshmitë për kërkesën nr.1. Certifikatë valide të regjistrimit të biznesit – kopje dhe dokumentet përcjellëse.**
		Kërkesa numër 2. Operatori Ekonomik duhet ta paraqes edhe dokumentin për regjistrim të TVSH-së.	**Dëshmitë për kërkesën nr.2. Kopja e vertetimit të regjistruar si OE tatimpagues i TVSH-së.**

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**apaciteti ekonomik dhe financiar:**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
		1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë prej jo më pak se 1,000,000.00 Euro	**1. Deklaratat Tatimore vjetore te dorëzuara ne ATK për tri vitet e fundit**
		2. Kapital financiar të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (lideri i grupit duhet te kete min. 60% te mbeshtetjes bankare) - 100,000.00 Euro	**2. Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi te pakushtezuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni. Bankar.**
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**apaciteti teknik dhe professional:**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
		1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimi për kontratë ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme në vlerë minimum 550,000.00 Euro (projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të objekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna)	**Dëshmia 1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve**
		2. Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me - ISO 9001-2015 - ISO 14001-2015 - ISO 31000-2018 - ISO 39001-2012 - ISO 45001-2018	**Dëshmia 1. Kopjet valide te certifikatave.**
		3. OE duhet te jete i licencuar leje per aktivitete te veqanta për	**Dëshmia 3- Kopja e licences lejes per aktivitete te**

		prodhimin e bazës se betonit	**veqanta të vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e OE. Marreveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit.**
		4. Lista e stafit professional - Menaxheri i projektit – inxhinier i ndërtimtarisë me së paku 5 vite pervojë profesionale - Udhëheqësi i punishtes – inxhinier i ndërtimtarisë me së paku 3 vite pervojë profesionale - Inxhinier i hidroteknikës - së paku 3 vite pervojë profesionale - Inxhinier i Komunikacionit - së paku 3 vite pervojë profesionale - Inxhinier i Elektroteknikës - së paku 3 vite pervojë profesionale	**Dëshmia 4 - Lista e stafit professional e nënshkruar dhe vulosur. Vendimi për caktimin e menaxherit të projektit dhe pozitave tjera. Kopjet e diplomave të noterizuara (Noterizimi jo më i vjetër se 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë). CV dhe referenca që dëshmojnë përvojën e kërkuar. Nëse OE nuk ka staf permanent atëherë si dëshmi duhet ofruar kontratat e noterizuara me emër dhe numër të projektit.**
		Sqarime plotësuese	**Autoriteti kontraktues mund të bëjë verifikimin e çdo dokumenti si dhe inspektimin e kapaciteteve teknike profesionale të gjithë operatorëve ekonomikë tenderues për qëllime të verifikimit. Nëse operatori ekonomik ka paraqitur të dhëna të rrejshme automatikisht do të eliminohet nga vlerësimi dhe oferta e tij do të konsiderohet si ofertë e**

		papërgjegjshme.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë teknike:

OE NPN EUROING SH.P.K. Nuk ka prezantuar dëshmi se në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimi për kontratë ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme në vlerë minimum 550,000.00 Euro (projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të objekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna)

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur 16

Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.P. ATC COM SH.P.K.; DAJTING SH.P.K. , Nuk ka prezantuar ISO Standarde për te gjithë anëtaret e grupit , Në përputhje me nenin 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, "Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përshtatshmërinë e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse".

Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; ARCHI TIME SH.P.K.; FlorinG SH.P.K.; Euro Commerc Nuk ka prezantuar dëshmi se në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimi për kontratë ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme në vlerë minimum 550,000.00 Euro (projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të objekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna) shi dhe Nuk ka prezantuar ISO Standarde për te gjithë anëtaret e grupit , Në përputhje me nenin 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, "Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përshtatshmërinë e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse".

Grup i Operatorëve Ekonomik NIKA PrO- Ing SH.P.K.; ENGINEERING RK SH.P.K. Nuk ka prezantuar dëshmi se në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimi për kontratë ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme në vlerë minimum 550,000.00 Euro (projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të objekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna) shi dhe Nuk ka prezantuar ISO Standarde për te gjithë anëtaret e grupit , Në përputhje me nenin 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, "Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përshtatshmërinë e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse".

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE konsiderohet pale me interes sipas LPP neni 4.1.26.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **NPN EUROING SH.P.K.**

Sqarim Hyrës:

Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK ka udhëhequr aktivitetin e Prokurimit: "Ndertimi i fushave te tenisit – Qendra Sportive ne Prizren" me nr. të prokurimit: "207-23-10441-5-1-1".

Me datë 28.09.2023 është publikuar njoftimi për kontratë;

Me datë 10.11.2023 Afati për dorëzimin e ofertave;

Me datë 22.12.2023 Formulari B58 – Njoftimi mbi vendimin e AK;

Me datë 25.12.2023 OE ka bërë kërkesën për rishqyrtim pranë AK;

Me datë 27.12.2023 AK ka nxjerrë vendimin mbi shqyrtimin e kërkesës dhe refuzon kërkesën si të pa bazuar;

Me datë 04.01.2024 OE ka paraqitur ankesë pranë OSHP me pretendimet ankimore;

Me datë 05.01.2024 OSHP ka autorizuar ekspertin shqyrtues për vlerësimin dhe shqyrtimin e ankesës së OE ankues.

Eksperti shqyrtues sipas autorizimit të datës 05.01.2024 në pajtim me LPP, ka shqyrtuar lëndën dhe pretendimet ankimore të OE ankues.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues në pretendimin ankimor 1 nuk është pajtuar me vlerësimin e AK në lidhje me kërkesën per kapacitetet teknike dhe profesionale ku AK ka vlerësuar se OE nuk ka prezantuar dëshmi se në 3 vitet e fundit ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme (projekte të realizuara në lëminë e objekteve sportive, stadiume apo salla sportive që përfshijnë tribuna) në vlerën e kërkuar në DT. OE ankues duke ju referuar projektit ekzekutues, si dhe paramasës dhe parallogarisë, konstaton se projekti i tenderuar nga AK me titull "Ndërtimi i Fushave të tenisit-Qendra Sportive Prizren" NUK KA TRIBUNA.

OE ankues ka shfaqur mospajtimet se AK nuk i ka marrë parasysh fare kontratat e përfunduara për ndërtimin e sallave të edukatës fizike për të cilat i ka ofruar dëshmitë OE ankues në formën e tabelave dhe kapin vlerën 855,383.87 euro, duke i konsideruar nga AK se Operatori ekonomik ankues nuk ka paraqitur asnjë objekt sportiv, stadiume apo salla sportive te cilat përfshinë tribunat. OE në dosjen e

tenderit i ka ofruar dëshmitë në lidhje me prezantimin e dokumenteve që dëshmojnë përfundimin me sukses të projekteve të natyrës së ngjashme për 3 vitet e fundit.

Përgjigje në pretendimin 1

Eksperti sqaron se AK në DT ka vendosur kërkesën në 9.1 &9.2. Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimi për kontratë ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme në vlerë minimum 550,000.00 Euro (projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të objekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna)

Dëshmia 1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.

Eksperti pas shqyrtimit të dokumenteve dhe në bazë të kërkesës së DT konsideron se AK në dosjen e tenderit ka vendosur kërkesën për realizimin me sukses të kontratave të "ngjashme". Sipas opinionit të dhënë nga KRPP termi "e ngjashme" nuk do të thotë se natyra e kontratës të jetë e njëjtë me përshkrimin e objekteve të dhëna në DT.

Sa i përket plotësimit të kërkesës eksperti sqaron se kërkesa e AK ka të bëjë me "objektet sportive, stadiume apo salla sportive që përfshijnë tribuna" që do të thotë se mjafton njëra nga këto llojet e objekteve të prezantohet në vlerën e kërkuar dhe kërkesa mund të konsiderohet e arritur sipas natyrës së kontratës.

Eksperti në bazë të raportit të vlerësimit nga komisioni i vlerësimit të ofertave, konsideron se AK gjatë vlerësimit është kufizuar në kërkesën e *"salla sportive që përfshijnë tribunat"* duke mos i konsideruar fare objektet tjera sportive siç i ka kërkuar ne DT.

OE ankues ka ofruar listën e kontratave të ngjashme të dëshmuara sipas kërkesës së DT, ndër të tjera ka ofruar 3 kontrata të sallave të edukatës fizike që mund të konsiderohen objekte sportive, duke arritur vlerën e kërkuar nga AK në DT dhe për më tepër, nëse AK ka pasur dilema në vërtetësinë apo validitetin e dokumenteve të ndonjë kontrate apo reference, është dashur të kërkojë sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor 1 është i bazuar.

Pretendimi ankimor 2

Pretendimi ankimor 2 ka të bëjë me qasjen në dokumentet zyrtare të kërkuara nga OE ankues, për të cilat ka shfaqur mospajtim OE ankues pasi që AK nuk i ka ofruar qasje të plotë me arsyetimin se të gjitha dokumentet janë të cilësuara si sekret afarist përveç paramasës, certifikatës së biznesit dhe sigurimit të tenderit. OE ankues ka shfaqur dyshimet e veta se OE i rekomanduar per kontratë ka mangësi.

Përgjigje në pretendimin 2

Eksperti shqyrtues ka shqyrtuar pretendimin ankimor 2 dhe konsideron se në funksion të zbatimit të RrPP nenit 64 - Paraqitja e ankesës dhe afateve kohore për dorëzimin e një ankese në OSHP, paragrafi 64.2 ndër të tjera thekson se *"Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues."* Pra në respektim të këtij neni OE ankues ka bërë shkelje gjatë parashtrimit të ankesës pran OSHP-së pasi që pretendimi ankimor 2 nuk është i paraqitur tek kërkesa për rishqyrtim pranë AK-së, për shkak të kësaj Eksperti konsideron se ky

pretendim, nuk do të trajtohet.

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor 2 duhet të hedhet poshtë si i pabazuar.

Pretendimi ankimor 3

Pretendimi ankimor 3 ka të bëjë me çmimin e dhënë për pozicionin e konstruksionit metalik për të cilin OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka dhënë çmim manipulues jo real me çmimet e tregut duke dhënë edhe sqarimet me çmimet e ofertuara nga OE ofertues në procedurë.

Përgjigje në pretendimin 3

Eksperti shqyrtues ka shqyrtuar pretendimin ankimor 3 dhe konsideron se në funksion të zbatimit të RrPP nenit 64 - Paraqitja e ankesës dhe afateve kohore për dorëzimin e një ankese në OSHP, paragrafi 64.2 ndër të tjera thekson se *"Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues."* Pra në respektim të këtij neni OE ankues ka bërë shkelje gjatë parashtrimit të ankesës pran OSHP-së, pasi që pretendimi ankimor 3 nuk është i paraqitur tek kërkesa për rishqyrtim, për shkak të kësaj Eksperti konsideron se ky pretendim, nuk do të trajtohet.

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor 3 duhet të hedhet poshtë si i pa bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe duke pasur parasysh edhe rekomandimin e lendes 2024-0003, rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **NPN EUROING SH.P.K.**

Enver Bytyçi